



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TE "UJËSJELLËS FSHAT" KORÇË SH.A

VENDIM Nr. 6 datë 05/04/2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË "UJËSJELLËS FSHAT"
KORÇË SH.A

Asambleja e përgjithshme e aksionarëve e shoqërisë "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, në mbështetje të Ligjit Nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura", të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 23, pikat 1 dhe 2, të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me ndryshime, nenit 135/ë, nenit 181, si dhe të nenit 7/1/d të Statutit të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A

VENDOSI

1. Të miratojë fillimin e procedurave për zvogëlimin e kapitalit të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, duke hequr kapitalet e ish Komunës Voskop, ish Komunës Drenovë, si dhe ish Komunës Bulgarec me përjashtim të Kaptazhit në Bulgarec, Depos Grumbullesë në Bulgarec dhe Linjës të transmetimit Bulgarec- Maliq, kapitale të cilat i transferohen Bashkisë Korçë.
2. Të emërojë Eksperten Kontabël të Autorizuar Znj. Eleonora Telo për të përgatitur raportin për zvogëlimin e kapitalit të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Asambleja e Aksionareve të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A

Sotirag Filo (Kryetari i Bashkisë Korçë)

Gëzim Topçiu (Kryetari i Bashkisë Maliq)

Bledion Nallbati (Kryetari i Bashkisë Devoll)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TE "UJËSJELLËS FSHAT" KORÇË SH.A

VENDIM Nr. 7 datë 18.04.2016

PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË "UJËSJELLËS FSHAT" KORÇË SH.A

Asambleja e përgjithshme e aksionarëve e shoqërisë "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, në mbështetje të Ligjit Nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura", të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 23, pikat 1 dhe 2, të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me ndryshime, nenit 135/ë, nenit 181, të nenit 7/1/d të Statutit të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, si dhe të Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar "Për zvogëlimin e kapitalit të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A "

VENDOSI

1. Zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, duke hequr kapitalet e ish Komunës Voskop, ish Komunës Drenovë, si dhe ish Komunës Bulgarec me përjashtim të Kaptazhit në Bulgarec, Depos Grumbullesë në Bulgarec dhe Linjës të transmetimit Bulgarec- Maliq, sipas Raportit të zvogëlimit të Ekspertit.
2. Në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi, Zvogëlimin e kapitalit të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, për vlerën 23.648.000 lekë.
Vlera e hequr është e barabartë me 23.648 aksione, me vlerë nominale 1 000 leke për çdo aksion.
3. Kapitali themeltar i "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A, pas ndryshimeve të mësipërme bëhet 116.032.000 lekë, i barabartë me 116.032 aksione, me vlerë nominale 1 000 lekë secili.
4. Në përputhje me pikën 3 të vendimit, në shoqërinë "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A:
- Bashkia Korçë ka në pronësi kapitalet e Kaptazhit në Bulgarec, Depos Grumbullesë në Bulgarec dhe Linjës të transmetimit Bulgarec- Maliq, me vlerë totale 25.798.000 lekë, që përbëjnë 22,2 % të aksioneve të Shoqërisë.
- Bashkisë Maliq ka në pronësi kapitalin me vlerë totale 80.456.000 lekë, që përbën 69,4% të aksioneve të Shoqërisë.
- Bashkisë Devoll ka në pronësi kapitalin me vlerë 9.778.000 lekë, që përbën 8,4% të aksioneve të Shoqërisë.
5. Ngarkohet Drejtoria e "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin në QKR.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Asambleja e Aksionareve të "Ujësjiellës Fshat" Korçë Sh.A

Sotirag Filo (Kryetari i Bashkisë Korçë)

Gëzim Topçiu (Kryetari i Bashkisë Maliq)

Bledion Nallbati (Kryetari i Bashkisë Devoll)





“ Ujësjetellës Fshat ” SHA

KORÇË

RAPORT

VLERESIMI

PËR ZVOGLIMIN E KAPITALIT

Tirane me 14 Prill 2016

Eleonora TELO
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
LËGENSE NR. 114, DATE 05. 04. 2006
NIPT L131330080

Page 1

TË NDERUAR ZOTËRINJ

Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". VKM Nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e urave të ndotura". Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Neni 23, pikat 1 dhe 2, Ligjin Nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Neni 135/ë, Neni 181, dhe, Statutin e "Ujësjetellës Fshat" Sh.A. Korçë Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.A me vendimin Nr.6 datë 05.04.2016

Vendosi :

Zvogëlimin e kapitalit themeltar/aksioner të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, me vlerën përkatëse të Aseteve/AAM (Aktive Afatgjata Materiale), te njësive administrative përbërëse që i shtohen Bashkisë Korçë në kuadër të zgjerimit të zonës së shërbimit sipas ndarjes territoriale.

Unë si Eksperte Kontabel e Regjistruar, vlerësoj se burim për zvogëlimin e kapitalit të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a është :

Kapitali themeltar/aksioner me gjendjen e paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2015, në regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve, me vlerë 139 680 000 lekë.

Unë kontrollova dhe vlerësova se vlera e kapitalit themeltar/aksioner të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, e paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2015, përkatësisht në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (Bilanc) në zërin Detyrimet dhe Kapitali, shënimi Nr.23, "Kapitali i nënshkruar", është e njëjtë me atë të paraqitur në gjendjen e regjistrimit sipas Ekstraktit të regjistrimit tregëtar (pika 8, Kapitali) si në vijim :

Table with 5 columns: Aksionerët, Vlera e Kapitalit, Numri i Aksioneve, Vlera Nominale e Aksionit, Përqindja e Pjesëmarrjes

Në kuadër të reformes territoriale, "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, ju hoqën nga administrimi Asete/AAM, Ndërtesa, Linja të transmetimit ujësjetellës e kanalizime, që i përkasin Bashkisë Korçë.

Eleonora TELO
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
LËGENSE NR. 114, DATE 05. 04. 2006
NIPT L131330080

Page 2

Sipas ndarjes territoriale ne territorin e Bashkisë Korçë do të kalojnë Asete/AAM dhe kapitali që ju perket atyre, i Komunës Voskop, Drenovë dhe Bulgarec për Fshatin Biranj dhe Lumalës.

Asetet/AAM që hiqen/pakësohen nga "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a zvogëlojnë njëkohësisht edhe kapitalin e Bashkisë Korçë.

Nga vlera e kapitalit prej 49 446 000 lekë e aksionerit Bashkia Korçë, shuma prej 25 798 000 lekë do të mbetet kapitali i aksionerit Bashkia Korçë në shoqërinë "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a. Vlera e kapitalit prej 25 798 000 lekë e aksionerit Bashkia Korçë përfaqëson vlerën e Aseteve/AAM të Kaptazhit në Bulgarec, Depos Grumbulluese në Bulgarec dhe Linjës së transmetimit Bulgarec, të cilat mbeten në administrim të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a. dhe paraqiten në Tabelën Nr.1 bashkëlidhur këtij raport.

Vlera e kapitalit të aksionerit Bashkia Korçë që zvogëlohet nga kapitali i "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, do të jetë 23 648 000 lekë (njëzet e tre milion e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë).

Zvogëlimi i kapitalit të aksionerit Bashkia Korçë për vlerën 23 648 000 lekë njëkohësisht zvogëlon edhe Asetet/AAM përkatëse.

Unë kontrollova dhe vlerësova se Asetet/AAM që i përkasin aksionerit Bashkia Korçë janë paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2015 të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, në Aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar (Bilancit), në zërin "Aktive Afatgjata Materiale (AAM) dhe në shënimet shpjeguese Faqë 4, me Vlerë Bruto, Amortizim të Akumuluar dhe Vlerë Neto.

Asetet/AAM të vlerësuar me Vlerë Bruto, Amortizim të Akumuluar dhe Vlerë Neto që i përkasin aksionerit Bashkia Korçë të cilat do të zvogëlohen nga vlera e Aseteve/AAM të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, me gjendjen e tyre në 31.12.2015 paraqiten në Tabelën Nr. 2 bashkëlidhur këtij raport.

Asetet/AAM paraqiten në Tabelën Nr.1 dhe Nr. 2 me vlerë fillestare/bruto dhe me amortizim të akumuluar.

Norma e amortizimit të asetëve është përllogaritur bazuar në vlerën fillestare/bruto dhe amortizimin e akumuluar të paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2015 të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a.

Norma mesatare e amortizimit e përllogaritur për ndërtesat vlerësohet te jetë 38,45 % dhe për linjat/rrejtin e ujësjetellës kanalizime vlerësohet të jetë 45,75 %.

Amortizimi i akumuluar për secilin Aset/AAM të paraqitur në Tabelën Nr.1, dhe Nr.2 është llogaritur sipas normave mesatare të sipër përmendura.

Kapitali i "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a, mbas zvogëlimit për shumën 23 648 000 lekë :

Nga 139 680 000 Lekë (njëqind e tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë),

Bëhet 116 032 000 Lekë (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e tridhjetë e dy mijë)

Eleonora TELO
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
LËGENSE NR. 114, DATE 05. 04. 2006
NIPT L131330080

Page 3

Kapitali i "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a ndahet në 116 032 aksione/kuota (Njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e dy)

Vlera nominale e çdo aksioni/kuota është 1 000 lekë (njëmijë).

Kapitali i "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a në vlerë 116 032 000 lekë, paraqitet i detajuar për çdo aksioner në vlerë, numër aksionesh, vlerë nominale dhe përqindje pjesëmarrje në Tabelën në vijim .

Table with 5 columns: Aksionerët, Vlera e Kapitalit, Numri i Aksioneve, Vlera Nominale e Aksionit, Përqindja e Pjesëmarrjes

ELEONORA TELO

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR



Eleonora TELO
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
LËGENSE NR. 114, DATE 05. 04. 2006
NIPT L131330080

Page 4

Vlera e Aseteve /AAM të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a që i përkasin aksionerit Bashkia Korçë

Table with 10 columns: Nr., Emri, Vili Korçë, Gjeqindja, Shëna, Pjesëtim, Gjeqindja, Shëna, Pjesëtim, Anëtarimi i Vlerës së mbetur

Vlera e Aseteve /AAM të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a që i përkasin aksionerit Bashkia Korçë

Table with 10 columns: Nr., Emri, Vili Korçë, Gjeqindja, Shëna, Pjesëtim, Gjeqindja, Shëna, Pjesëtim, Anëtarimi i Vlerës së mbetur

Vlera e Aseteve /AAM të "Ujësjetellës Fshat" Korçë Sh.a që i përkasin aksionerit Bashkia Korçë

Table with 10 columns: Nr., Emri, Vili Korçë, Gjeqindja, Shëna, Pjesëtim, Gjeqindja, Shëna, Pjesëtim, Anëtarimi i Vlerës së mbetur





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UJESJELLES KANALIZIME MALIQ

Maliq 31.03.2017

VENDIM

Nr.1, date 31.03.2017

"Shtim kapitali, aksione"

Ne mbeshetje te Ligjit nr.9901, dt 14.04.2008 "Per tregaret dhe shoqerite tregetare", neni 135, pika 2, germa e, pas vleresimit te kapitaleve nga eksperti kontabel i autorizuar te ujesjellesave ekzistues prane Bashkise Maliq, Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve,

VENDOSI:

1-Te shtoje kapitalin e ardhur nga vleresimi i ujesjellesave qe deri tani funksionojne prane bashkise Maliq ,prane Sh.a Ujesjelles Kanalizime Maliq ne vleren 404.778.000 leke (katerqind e katermilion e shtateqind e shtatedhete e tete mije),ne aksione 404.778 (katerqind e katermije e shtateqind e shtatedhete e tete), sipas raportit te ekspertit kontabel.

2-Te miratoje prane Keshillit te Bashkise kalimin e kapitaleve ne Sh.a Ujesjelles kanalizime Maliq.

3-Per ndjekjen e ketij vendimi ngarkohet Keshilli Administrativ.

4-Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit nga ana e Keshillit te Bashkise.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

KRYETARI I BASHKISE MALIQ

GEZIM TOPÇIU

KRYETARI I BASHKISE KORÇE

SOTIRAQ FILO

KRYETARI I BASHKISE DEVOLL

BLEDION NALLBATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

UJESJELLES KANALIZIME SH.A MALIQ

Vendim nr 1 ,date 31.03.2017

Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve te Shoqerise, ne zbatim te nenit 135, pika 2, germa e, te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregaret dhe shoqerite tregetare", ndryshuar, pas vleresimit te kapitaleve nga eksperti kontabel i autorizuar ,te ujesjellesave ekzistues prane Bashkise Maliq

VENDOSI:

1-Te shtoje kapitalin e ardhur nga vleresimi i ujesjellesave qe deri tani funksionojne prane Bashkise Maliq ne vleren 520 810 000 lek ose 520 810 aksione si me poshte:

a)Bashkia Maliq me 485 234 aksione ose 93.169%

b)Bashkia Korce me 25 798 aksione ose 4.953 %

c)Bashkia Devoll me 9 778 aksione ose 1.877%

2-Ngarkohet Drejtoria e shoqerise per depozitimin e tij prane QTB.

3-Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

MIRATOI

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE TE

"UJESJELLES -KANALIZIME SH.A MALIQ"

Gezim Topciu (Kryetar i Bashkise Maliq)

Sotiraq Filo (Kryetar i Bashkise Korce)

Bledjon Nallbati (Kryetar i Bashkise Devoll)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A MALIQ
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

VENDIM NR. 1, DATË 25 / 03 / 2020

PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT NË NATYRË TË SHOQËRISË

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve , pasi u njoh me raportin e ekspertës kontabël znj. Anila Cunoti, për zvogëlim kapitali në natyrë si dhe duke analizuar “Aktin e transferimit dhe marrjes në dorëzim “ nr. 123 prot,datë 05,03,2020; nr.23 prot,datë 06,03,2020: Vendimi nr.149,datë 22.11.2019 i Këshillit të Bashkisë Maliq, në zbatim të nenit 135,pika 1, pika 2/ë/f të Ligjit nr.9901,datë 14,04,2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” ,ndryshuar ,neni 7,paragrafi 1 ,pika d) të statutit të shoqërisë

VENDOSI:

- 1-Miratimin zvogëlimit të kapitalit në natyrë të “Ujësjellës Kanalizime Sh.a Maliq” nga 520 810 000 lekë (520 810 aksione) në 453 137 000 lekë (453 137 aksione)
- 2- Bashkia Maliq ka 417 561 aksione ose 92,15 %
Bashkia Korçë ka 25 798 aksione ose 5,69%
Bashkia Devoll ka 9 778 aksione ose 2,16%
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

Gëzim Topçiu Kryetar i Bashkisë Maliq

Sotiraq Filo Kryetar i Bashkisë Korçë
(Përfaqësuar nga Anxhela Dishnica)

Eduard Duro Kryetar i Bashkisë Devoll



Te nderuar zoterinj aksionere te shoqerise !

Ne baze te Ligjit Nr 115/2014 date 31.07.2014 "Per ndarjen administrative teritoriale te nejsive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise " te VKM nr 63 ,date 27.01.2016 " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem ,grumbullimin ,largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura " te Ligjit Nr 139/2015"Per vetqeverisjen vendore" Nenit 23,pika 1 dhe 2 te Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtarete dhe shoqerite tregtare me ndryshime ,nenit 135/e nenei 181 si dhe te nenit 7/1/d te Statutit te Ujesjellesit Fshat " Korce Sh.A. Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve me Vendim nr 6 date 20.12.2019 ka vendosur zmadhimin e kapitalit te shoqerise Ujesjelles Fshat Korce Sh.A. duke shtuar asetet e Agjensise te Ujesjelles Kanalizimeve Bashkia Maliq,Sipas pikes dy te ketij vendimi une jam emeruar si Eksperte Kontabel e Autorizuar per te bere zmadhimin e kapitalit.

Si Eksperte qe jam caktuar per vleresimin e kontributit jam mbeshtetur ne Legjislacionin e mesiperme si dhe ne Pasqyrat Financiare te shoqerise si dhe raportin e zvogelimit te kapitalit

Njohja me shoqerine

Shoqeria UJESJELLES KANALIZIM MALIQ Sh.A. me NIPT J64103106D eshte themeluar si shoqeri ne 15/05/2003.

Selia kryesore ndodhet ne Blloku Nr. 1, Bulevardi Rinia, Objekti Nr. 1/220 Maliq

Objekti i veprimtarise : Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij.Mirembajtja e sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhim dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkesave te konsumatoreve. Shoqeria mund te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, 2 brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.Shoqeria do te kryeje cdo veprim me qellim marjen e lejeve,autorizimeve,licencave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj,per te cilat kerkohen

Page 2

keto dokumente administrative. Sherbimi i grumbullimit , largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura. Mirembajtja e sistemeve te ujrave te ndotura si dhe impianteve te pastrimit te tyre

Sistemi i administrimit eshte me nje nivel.

Administrator i shoqerise eshte Petrit Kupe

Anetar te keshillit administrativ jane:

Panajot Pilani

Bashkim Hazisllari

Petrit Kupe

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A. ka nje kapital te nenshkuar ne vleren 520,810,000 leke sipas ekstraktit historik i ndare ne 520,810 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili .

Sipas ekstraktit historik gjendja e aksioneve eshte si me poshte:

Aksioneret	Vlera e kapitalit	Nr i aksioneve	Vlera nominale	Ne Perqindje
Bashkia Korce	25,798,000.00	25798	1000	4.95%
Bashkia Devoll	9,778,000.00	9778	1000	1.88%
Bashkia Maliq	485,234,000.00	485234	1000	93.17%
TOTAL	520,810,000.00	520810		100.00%

Une si Eksperte vleresoj se burimi i zvogelimit te kapitalit jane vlere e asetete ujesjelles dhe kanalizime te cilat e Bashkia Maliq ia kaloi Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A .

Page 3

Ne zmadhimin e kapitalit te kryer ne daten 30/03/2017 publikuar ne QKB ne daten 23/06/2017 shoqerise Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A. i eshte zmadhur kapitali ne natyre nga transferimi i aseteteve nga Bashkia Maliq ne vleren 404,778,000 leke

Sipas riverifikimit te kryer nga Bashkia Maliq,vendimit te Bashkise Maliq nr 149 date 22.11.2019 vlere e ketyre asetave qe duhet ti transferohej shoqerise Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A. duhet te ishte 337,104,706 leke.

Vlera neto e aseteteve te ujesjelles kanalizimeve te Bashkise Maliq jepen sipas tabelës bashkengjitur ketij raporti dhe kapin vleren 337,104,706 leke.Per vleren 67,673,294 leke duhet bere zvogelim i kapitalit ne natyre te shoqerise Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A.

Une kontrollova dhe vleresova inventarin e aseteteve te deklaruar nga Bashkia Maliq per investimet te financura nga projekte ose fonde nga buxheti i shtetit Shqiptar dhe shprehem qe Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A. duhet te zvogeloje kapitalin ne vleren 67,673,000 leke dhe te zvogeloje rezervat ligjore vleren 294 leke

Per rrjedhoje, do të anulloje 67,673 Aksione me vlere nominale prej 1000 lekë për aksioner qe i perkasin kuotave te Bashkise Maliq

Pas zvogelimit te kapitalit kapitali i shoqerise behet 453,137,000 leke i ndare ne aksione si me poshte

Aksioneret	Vlera e kapitalit	Nr i aksioneve	Vlera nominale	Ne Perqindje
Bashkia Korce	25,798,000.00	25798	1000	5.69%
Bashkia Devoll	9,778,000.00	9778	1000	2.16%
Bashkia Maliq	417,561,000.00	417561	1000	92.15%
TOTAL	453,137,000.00	453,137		100.00%

Page 4

Shoqeria UJESJELLES KANALIZIME MALIQ Sh.A . mund te zvogeloje kapitalin ne natyre ne kundrvleren e saj 67,673,000 (gjashtedhjet e shtatemije e gjashtedhjet e tre) leke duke anuluar 67,673 aksione .Numri i aksioneve behet 453,137 aksione me vlere nominale 1,000 leke

Veprimi kontabel pas zvogelimit te kapitalit do te jene si me poshte:

Debi : llog 101 "Kapitali i nenshkuar i "67,673,000 leke

Debi:llog 1071 " Rezervat ligjore "294 leke

Kredi : Llog 213" Instalime teknike ,makineri e pajisje".....67,673,000leke

Per caktimin e vleres dhe menyres ne te cilen do te behet ky zvogelim kapitali duhet te shprehet mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme te Aksionereve.

Per kryerjen e misionit te ngarkuar jemi mbeshtetur ne:

❖ Vendimin e Asamblese te Aksionereve te shoqerise Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A. date 20.12.2019.

❖ Pasqyrat Financiare te shoqerise

❖ Pasqyren e levizjes se kapitalit

❖ Ekstraktin historik te shoqerise prane QKR

❖ Ligjin Nr 9901 date 14.04.2008"Per Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare", Ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 I ndryshuar "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

❖ Ligjin Nr 115/2014 date 31.07.2014 "Per ndarjen administrative teritoriale te nejsive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise"

❖ VKM nr 63 ,date 27.01.2016 " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijshem ,grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura

Page 5

❖ Inventarin e aseteteve me te cilat zvogelohet kapitali sipas listes bashkengjitur te Bashkise Maliq

❖ Aktin e marjes ne dorezim te aseteteve i nenshkuar neg te dy perfaqesuesit e Bashkise Maliq dhe Administratori i shoqerise Ujesjelles Kanalizime Maliq Sh.A.

Ky raport u plotesua ne tre kopje te njejta nga te cilat dy kopje I jepen shoqerise dhe nje kopje i mbajne Ekspertet Kontabel te Regjistruar .

Ekspert Kontabel I Regjistruar

Korce me 09.03.2020

Anila ÇUNOTI



Page 6